

Fondi i Kursimeve Pensionale i Kosovës (FKPK) është institucion i pavarur, i themeluar për të administruar sistemin e kursimeve të obligueshme pensionale në Kosovë, dhe vepron në kuadër të Ligjit Nr. 04/L-101 për fondet pensionale në Kosovë dhe me plotësimet e mëtutjeshme të këtij ligji. FKPK-ja, në përputhje me nenin 8 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 e shpall këtë:

KONKURS PUBLIK

për angazhimin me kontratë për punë dhe detyra specifike sikur në vijim:

Titulli i pozitës:

Zyrtar i Sigurisë së Informacionit

Orët e punës:

Jo më shumë se 120 ditë në vit

Numri i referencës:

KON122024

Kohëzgjatja e emërimit:

Kontratë për punë dhe detyra specifike

Adresa:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 182-184, 10000 Prishtinë

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Zyrtari i Sigurisë së Informacionit është përgjegjës për monitorimin, konfigurimin dhe përmirësimin e masave të sigurisë në rrjet dhe sistemet e FKPK-së. Qëllimi kryesor është mbrojtja e të dhënave të ndjeshme dhe siguria e vazhdueshme ndaj kërcënimeve kibernetike. Detyrat përfshijnë:

- Monitorimi dhe konfigurimi i sistemeve të sigurisë.
- Menaxhimi i cenueshmërive.
- Rishikimi i dobësive dhe incidenteve.
- Testimi dhe përmirësimi i sigurisë.
- Qeverisja dhe menaxhimi i sigurisë së informacionit.
- Vetëdijesimi për sigurinë e informacionit.
- Mbështetja për vazhdimësinë e biznesit.
- Menaxhimi i rrezikut dhe mbrojtja e të dhënave.

Linku me të dhënat më të detajuara: <https://trusti.org/sq/per-ne/per-fkpk/jobs-alb/specifikimet-teknike-per-zyrtar-te-sigurise-se-ti-se/>

Kandidati ideal do të duhet të ketë:

- Njohuri të thella për skanimin e dobësive, monitorimin e sigurisë dhe menaxhimin e incidenteve.
- Aftësi të mira në analizimin dhe vlerësimin e rrezikut dhe incidentet e sigurisë.
- Aftësi të shkëlqyera për komunikim, bashkëpunim dhe raportim të qartë.

Kriteret:

Arsimimi:

Diplomë universitare (baçelor) në shkenca kompjuterike ose TIK.
Certifikime të vlefshme si CompTIA Security+, CEH, CISSP, CySA+ ose ekuivalente.

Përvoja:

Përvojë së paku dyvjeçare në sigurinë e informacionit ose në një rol të ngjashëm.

Referenca:

Së paku dy (2) referenca që e dëshmojnë angazhimin/përvojën përkatëse profesionale.

Afati dhe mënyra e konkurrimit:

- Konkursi është i hapur prej: **21 nëntor deri 6 dhjetor 2024 në 23:59 (CET)**.
- Aplikimi bëhet vetëm përmes email-it në adresën: **recruitment@trusti.org**, me referencë: "Zyrtar i Sigurisë së Informacionit"
- Email-it duhet t'i bashkëlidhen edhe dokumentet në vijim: diploma, biografia (CV), letërmotivimi dhe certifikatat profesionale në fushën përkatëse (nëse ka).

Informim paraprak:

- Aplikacionet që nuk i kanë të bashkëngjitura dokumentet e lartcekura NUK do të shqyrtohen! Vetëm kandidatët që i plotësojnë kushtet e konkursit do të kontaktohen.
- Kandidatët mund t'i nënshtrohen testimit për vlerësimin e aftësive të kërkuara.

FKPK-ja është punëdhënës që ofron mundësi të barabarta për të gjithë!